

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Vendimi në Hagë, ja hapat që ndërmerren për apelimin e një vendimi të Speciales! Top Albania Radio
ADRESA	https://www.topalbaniaradio.com/vendimi-ne-hage-ja-hapat-qe-ndermerren-per-apelimin-e-nj-e-vendimi-te-speciales/
BURIMI	topalbaniaradio.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	16 shtator 2026, 17:35:58 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	16 shtator 2026, 17:25:08 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	1782aa4425e564b044167430aad151e7a2314a4880d8cdf8d68dd9317eb5df1e
TEKSTI	3c98bfa45d71bafd2e40753c85a5abd00991806692ae6473d3e0de2034a6da77
PAMJA	3a7a309fab0894c5bac0d62932e5011c6a9e60cd0b1389ca5839f1bfb7e061d4

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	33114500a7b95d10eb1fe86980b6c8a38a2c0578e1f7d16ec4422fddefd03510
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	9515102868483048fab913125dfd13516db18986db3bd96a2369642ebf1c0d96
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/33114500a7b95d10eb1fe86980b6c8a38a2c0578e1f7d16ec4422fddefd03510>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



Aktualitet Rajoni

Vendimi në Hagë, ja hapat që ndërmerren për apelimin e një vendimi të Speciales!



Ervin Nikolla

16 Shtator 2026



TOP ALBANIA RADIO

Ekipet mbrojtëse të ish-eporëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës kanë paralajmëruar se do të apelojnë **aktgjykimin dënues** të shqiptuar nga trupi gjyqësor i Dhomave të Specializuara të Kosovës në Hagë më 16 shtator.

Hashim Thaçi u dënua me 25 vjet burgim për katër pika të aktakuzës për krime lufte, Jakup Krasniqi po ashtu u dënua me 25 vjet burgim, ndërkaq Kadri Veseli me 18 dhe Rexhep Selimi me 13 vjet burgim.

Të katër ish-eporët e UÇK-së u shpallën penalisht përgjegjës për krime lufte që përfshijnë ndalimin e paligjshëm ose arbitrar, trajtimin mizor, torturën dhe vrasjen e paligjshme. Gjatë aktgjykimit të shqiptuar në Hagë, trupi gjyqësor hodhi poshtë akuzat e ZPS-së për krime kundër njerëzimit.

Katërshja e UÇK-së gjendet në paraburgim në Hagë që nga nëntori i vitit 2020.

Vendimi i trupit gjyqësor mund të apelohej nga palët e përfshira, nga mbrojtja e cila mund të kërkojë rrezimin e aktgjykimin në tërësi apo të synojnë uljen e dënimit për pika të caktuara të akuzës, por edhe Zyra e Prokurorit të Specializuar që mund të kërkojë ashpërsim të dënimit.

ZPS-ja mirëpriti vendimin dënues dhe shtoi se do të shqyrtojë të gjithë aktgjykimin, përfshirë edhe rrezimin e pikave të akuzës që kishin të bënin me krime kundër njerëzimit.

Por, cilat janë procedurat që palët ndjekin për apelim?

Sipas Rregullores së Procedurës dhe Provave, palët që apelojnë vendimin e gjykatës ose dënimit, ose të dyja së bashku, duhet të dorëzojnë atë që quhet njoftimin për apel, ku parashtrihen arsyet e apelimin, 30 ditë nga shpallja e aktgjykimin.

Më pas, kryegjykatësi i panelit të Gjykatës së Apelit – gjykatë që përbëhet nga tre anëtarë – mund të caktojë një prej gjykatësve si gjykatës raportues për procedurën paraapeluese. Gjykatësi raportues ka për detyrë të marrë masat e nevojshme për aspektet procedurale, sikurse janë lëshimi i vendimeve, urdhrave dhe udhëzimeve me qëllim që të përgatitet çështja për shqyrtim. Ai duhet që rregullisht ta informojë panelin e Gjykatës së Apelit, veçmas nëse ka kontestime lidhur me çështjet procedurale.

Më pas, brenda 21 ditësh nga njoftimi për apel, kryegjykatësi apo gjykatësi raportues e thërret një konferencë ku ngrihen çështje rreth apelit.

Palët që parashtrojnë apel duhet të dorëzojnë dosjen e apelit e cila përmban të gjitha argumentet dhe burimet të tjera ligjore ku mbështeten arsyet e apelimit. Kjo duhet të dorëzohet brenda 60 ditësh apo brenda 30 ditësh nga njoftimi për apel, nëse çështja ka të bëjë vetëm me dënimin e shqiptuar.

Më pas palët dorëzojnë të ashtuquajturën dosje të përgjigjes, ku paraqesin argumentet ligjore të tyre. Afatet se kur dorëzohet kjo dallojnë: 30 ditë për argumentet dhe burimet ligjore dhe 15 ditë vetëm për dënimin nga paraqitja e dosjes. Kjo pasohet me dosjen e kundërpërgjigjes për të cilën afatet janë më të shkurtra, 15 dhe 10 nëse ka të bëjë vetëm me dënimin.

Pas gjithë këtyre afateve, Gjykata e Apelit e cakton datën e një seance “nëse është e nevojshme”, thuhet në rregulloren.

Rregullorja parasheh që palët mund të dorëzojnë prova shtesë gjatë procedurës së apelimit dhe nëse ato pranohen, pala tjetër mund të paraqesë kundërprova.

Gjatë vendimit, Paneli i Apelit shqyrton çdo provë shtesë të pranuar, por edhe provat që veçse janë pjesë e dokumentacionit.

Sapo të përfundojnë parashtrimet nga palët, paneli i Apelit mblidhet dhe shqyrton çështjen dhe nxjerr aktgjykim për dokumentacionin e apelit dhe për çdo provë shtesë të pranuar.

Pra, Gjykata e Apelit mund të lërë në fuqi, të zhbëjë ose të ndryshojë aktgjykimin e trupit gjykues apo të mbahet rigjykim.

Megjithatë, nëse kërkesa për apel bëhet vetëm nga personat e shpallur fajtorë, Gjykata e Apelit nuk mund të shqiptojë vendim më të rëndë se shkalla e parë.

Vendimi i apelit shqiptohet brenda 60 ditësh nga parashtrimi i fundit i palëve. Megjithatë, edhe për këtë mund të kërkohet kohë shtesë, por jo më shumë se një muaji dhe zgjatja e afatit duhet të arsyetohet.

Sipas Ligjit për Dhomat e Specializuara dhe Zyrës së Prokurorit të Specializuar janë tri arsye për të cilat mund të dorëzohen apele për vendime të shkallës së parë: ndonjë gabim rreth ndonjë çështje juridike që e shfuqizon aktgjykimin, ndonjë gabimi faktik i cili ka shkaktuar dështimin e drejtësisë ose ndonjë gabimi për sa i përket dhënies së dënimit.

Nëse palët nuk janë të kënaqura me vendimin e Apelit, çështja mund të dërgohet në Gjykatën Supreme dhe më pas në atë Kushtetuese të Dhomave të Specializuara në Hagë.

Mbrojtësit e ish-presidentit, Hashim Thaçi, thanë se procesi i apelimit mund të marrë vite kohë.

LAJME TË NGJASHME



Këshilli i Ambasadorëve Shqiptarë reagon pas dënimeve në Hagë: Zhgënjim i thellë, procesi ngre shqetësime serioze!

1 MIN



Deputetja e PDK, Sala Jashari kërkon zhbërjen e Speciales: Kuvendi të mblidhet në seancë të jashtëzakonshme


2.5 MIN





Marta Kos kërkon respektimin e vendimit të Hagës:
Vetëm pajtimi e çon rajonin drejt BE-së!

2.5 MIN



Dënimi i liderëve të UÇK-së, reagon zv.kryeministri
shqiptar i Malit të Zi: Vendim jashtëzakonisht i
padrejtë!

2 MIN



Nuk kënaqet me 81 vite burg për ish-krerët e UÇK,
Prokurorja e Specializuar e Hagës: Do kërkojmë në
Apel dënim edhe për krimet kundër njerëzimit!

3.5 MIN

MË TË LEXUARAT



Sot verdikti i Hagës/ Konjufca:
Presim vetëm një vendim, lirim
e katër ish-krerëve të UÇK-së



Charles Smith kryeson trupin
gjyqësor në Hagë



LAJMI I FUNDIT/ Kadri Veseli
dënohet me 18 vite burg



Grupi gjyqësor: Të katërt ish-
anëtarët e UÇK-së penalisht
përgjegjës për krime lufte




Gjykata speciale në Hagë jep sot
vendimin për Thaçin dhe ish-
krerët e tjerë të UÇK-së



Rexhep Selimi dënohet me 13
vjet burgim



Haga/ Krasniqi dënohet me 25
vite burgim



Ish-presidenti i Kosovës, Hashim
Thaçi dënohet me 25 vjet burgim
për krime lufte



Kush janë gjyqtarët që do të
shpallin sot vendimin për ish-
krerët e UÇK-së në Hagë?



Nis seanca në Hagë për shpalljen
e vendimit për Thaçin, Veselin,
Selimin e Krasniqin


EDITORI SUGJERON



Çfarë nuk duhet të mungojë në
dietën tuaj për flokë të
shëndetshëm...



Lorenc Hasrama risjell këngën e
Flori Mumajesit live në studio!



Lorenc Hasrama kujton situatën
me qesharake që i ka ndodhur në
koncert!




Cili ka qenë përfaqësimi më i
mirë në "Eurovision" sipas
Lorenc Hasramës...



Lorenc Hasrama: "Kam zgjedhur
të jap më të mirën, festivalet..."



"Në fillim nuk kam patur
ndonjë..." / Lorenc Hasrama
kujton pjesëmarrjen në "The
Voice of Albania"!





Në lidhje me Jonida Maliqin?
Alessio vihet në siklet: "Ja
kalojmë shumë mirë, na bëjnë
foto sepse..."



Një natë, shumë ritme dhe një
ndalesë që nuk e kishim
planifikuar!



Nga dëshira për të prekur
"Eurovisionin" deri tek situata
më e sikletshme në koncert, flet
Lorenc Hasrama!



"Po sikur...?" Ja si mendimet më
të zakonshme na fusin në alarm...

RRETH NESH

Top Albania Radio promovon muzikën më të
zgjedhur shqiptare dhe të huaj, me edicionet
informativ dhe një larmi programesh kulturore.
27 vjet transmetim, për të dhënë më të mirën.

KONTAKT

Address: Sheshi Italia 1, Arena Center, Tirana,
Albania
Email:

Tel: +355 69 208 0500
+355 69 442 8873

COPYRIGHTS

Përmbajtja e këtij website është pronë e Top
Albania Radio. Kopjimi, përdorimi apo
riprodhimi i paautorizuar i tij, përbën shkelje
penale.

LINKS

[Kontaktoni](#)
[Marketing](#)
[Frekuencat](#)
[Aksesueshmëria](#)
[Mundësi Punësimi](#)
[Privacy Policy & Terms](#)

JavaScript is required for [tabnav](#) widget to work properly.

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.